



BASHKIA MIRDITË

Nr. 77 prot

Rrëshen, me datë 08 01 2025

**URDHËR** Nr. 04 Dt. 08.01.25

**Për një ndryshim të vendimit nr.2 dt.08.01.2024**

**“Për miratimin e strukturës organike të Bashkisë Mirditë për vitin buxhetor 2024”**

Në mbështetje të pikës j, nenit 64, te ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; ligjit nr.44/2015 "Kodi i Procedurës Administrative në Republikën e Shqipërisë"; të ligjit nr. 35/2023 "Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi", në ligjin 152/2013 "Për nëpunësin civil në RSH-së", në "Kodin e Punës së RSH-së", VKB nr.50 datë 15.12.2023., "Për miratimin e buxhetit të vitit 2024" Bashkia Mirditë, konfirmuar me shkresën nr.1038/2, të Prefektit të Qarkut Lezhë, si dhe domosdoshmërinë e pozicionit të Sekretarit të Përgjithshëm për mirëfunksionimin e administratës,

**URDHËROJ:**

- 1-Në strukturën organike të B.Mirditë - seksioni I/3 - Njësia e Integritimit Europian dhe projekteve, të shkurtohet një vend specialist nga numri total i punonjësve dhe nëpunësve.
- 2-Brenda numrit total të miratuar në Këshillin Bashkiak, të shtohet pozicioni " **Sekretar i Përgjithshëm**".
- 3-Për emergjencat vendore, evenimente ose situata të paparashikueshme, bashkia të kontraktojë për një peuridhë jo më shumë se 6-mujore, nga të ardhurat e veta, deri **30** punonjës, (punëtor sezonal me kohë të pjesshme).
- 4-Ky ndryshim nuk duhet të kalojë numrin e përgjithshëm të punonjësve dhe nëpunësve të miratuar në këshill.
- 5-Me zbatimin e urdhërit ngarkohet Drejtoria Burimeve Njerëzore, Juridike dhe Marrëdhënieve me Publikun dhe Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Tatim –Taksave.  
**Ky urdhër hyn në fuqi pas regjistrimit në protokoll !**

**KRYETARI**

**Albert MËLYSHI**



Adresa: Sheshi "Abat Doçi" Rrëshen Mirditë tel.+355 216 22 33  
Email:www.bashkiamirdite.gov.al